

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FORCËS REZERVISTE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti, konkretisht projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit rezervist në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak rezervist.

Projektligji për shërbimin ushtarak në rezervë do të shërbejë për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar, si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në rastet e përkeqësimit të gjendjes së sigurisë, si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale, si dhe operacionet e emergjencave civile.

Aktualisht, shërbimi ushtarak në rezervë, gjen rregullim të pjesshëm në disa nene me ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj është miratuar përpara 17 vitesh dhe ka përcaktuar rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet e organeve shtetërore dhe subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak. Ai është hartuar në vitin 2003 dhe objekt i tij është shërbimi i detyrueshëm ushtarak, si ai aktiv dhe ai në rezervë. Nga viti 2003 kanë ndodhur shumë ndryshime si në FA, ashtu edhe në shoqërinë dhe shtetin shqiptar.

Për funksionimin e strukturës rezerviste në Forcat e Armatosura janë përcaktuar detyrime për shërbimin e detyrueshëm ushtarak në rezervë në ligjin e sipërcituar. Gjithashtu, për rezervën në Forcat e Armatosura kanë përcaktuar detyrime edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103 datë 10.02.2016 “Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 25.9.2019 “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, ku

është përcaktuar se: “Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive)”.

Me gjithë përpjekjet për krijimin dhe funksionimin e strukturës organike të rezervës në Forcat e Armatosura, hartimit të konceptit të përdorimit apo akteve për këtë strukturë, krahas traditës së FA-së në të kaluarën, lind domosdoshmëria e funksionimit të saj nga anëtarësia në NATO, nga përvoja dhe kërkesat e vazhdueshme të Aleancës, për përqindjen e fillimit të aktivizimit të kësaj strukture, nga situata rajonale e sidomos nga konflikti aktual Rusi-Ukrainë.

Me anëtarësimin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë pësuar ndryshime të mëdha në të gjitha drejtime. Një nga ndryshimet thelbësore ka qenë kalimi nga një shërbim ushtarak i detyrueshëm në një shërbim me baza vullnetare.

Në këto kushte, për të përballuar gjithë gamën e sfidave dhe vështirësive që kohët e fundit janë gjithnjë e në rritje, forcat e shërbimit ushtarak në rezervë duhet të konsiderohen si një pjesë e vlefshme dhe e çmuar e Forcave tona të Armatosura, të cilat me pjesëmarrjen e tyre në misione, krahas forcave aktive, do të sjellin kapacitete shtesë, kontribut në rritjen, mbështetjen dhe fuqizimin e kapaciteteve operationale, si dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm, praktik e konkret në përballimin e sfidave të çdo natyre e lloji.

Për krijimin dhe mirëfunksionimin e shërbimit ushtarak në rezervë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në vijim dhe të arsyetimit të mësipërm, është parë e nevojshme hartimi i një ligji të ri, sikundër është dhe projektligji i paraqitur “Për organizimin e shërbimit ushtarak në rezervë në Republikën e Shqipërisë”, me anë të së cilit synohet të riformulohen dhe të shtohen disa përcaktime, të drejta e detyrime, në funksion të qartësisë ligjore dhe në plotësim të disa vakumeve të hasura gjatë zbatimit të akteve ligjore aktuale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet projektligjit Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë synohet standardizimi dhe harmonizimi i normave ligjore përkatëse, për të siguruar individëve të trajnuar me qëllim kompletimin e strukturës së shërbimit ushtarak në rezervë në

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar, si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në rastet e përkeqësimit të gjendjes së sigurisë, si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale, si dhe operacionet e emergjencave civile.

Ky projektligj është i domosdoshëm, pasi aktet ligjore në fuqi nuk ndihmojnë në organizimin e një force rezerviste, sipas standardeve të NATO-s dhe do të mundësojë rregullimin e marrëdhënieve ligjore që aktualisht janë harmonizuar.

Ligji nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar rregulla për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, i cili kryhet në tri forma:

- a) shërbim ushtarak aktiv;
- b) shërbim alternativ, si dhe;
- c) shërbim në rezervë.

Duke filluar nga viti 2010, ky ligj në veçanti për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv filloi të aplikohet jo më mbi bazën e detyrimit, por mbi baza vullnetare, fillimisht si ushtar me pagesë, ndërsa sot me emërtim “ushtar/detar aktiv”. Ndërsa për shërbimin ushtarak në rezervë për plotësimin e strukturave të Forcave të Armatosura, më gjithë përpjekjet e bëra për ngritjen e strukturave e funksionimin e saj, sipas eksperiencës së vendeve të NATO-s, akoma nuk është bërë organizimi dhe përdorimi i komponentit në rezervë.

Ligji 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka rregulluar sistemin e menaxhimit të karrierës ushtarake në Forcat e Armatosura, duke përcaktuar si subjekte të tij, ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, studentët ushtarakë dhe ushtarakët në rezervë dhe nuk ka njohur si pjesë të Forcave të Armatosura, në ndryshim nga ligji i mëparshëm (ligji nr. 9171/2004, i shfuqizuar), ushtarakët e shërbimit të detyrueshëm.

Në pikën 18, të nenit 6, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: *“Njësi ushtarake rezervë” është strukturë e Forcave të Armatosura, e organizuar dhe e kompletuar me armatim, pajisje, teknikë, infrastrukturë dhe me një minimum personeli aktiv për trajnim dhe mirëmbajtje, e cila aktivizohet dhe kompletohet me personel rezervist sipas nevojës”.*

Gjithashtu për rezervën në Forcat e Armatosura kanë përcaktuar detyrime edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103 datë 10.02.2016 “Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 25.9.2019 “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, ku është përcaktuar se: “Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive)”.

Sikurse është parashtruar dhe më sipër, projektligji paraqet rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak në rezervë në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak në rezervë.

Sa i takon përmbajtjes, është i organizuar në 2 krerë dhe 36 nene. Kreu i parë “Dispozita të përgjithshme” është i konceptuar në 15 nene, ku përcaktohen krahas objektit, përkufizimeve dhe qëllimit disa kritere të përgjithshme që lidhen organizimin e këtij shërbimi, si mosha e kryerjes së shërbimit, titullimi dhe gradimi, kohëzgjatja dhe kushtet e shërbimit, të drejtat dhe detyrimet, paga, vjetërsia në punë e shërbim etj.

Kreu i dytë “Detyrimet e autoriteteve përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak në rezervë“, është i përbërë nga 21 nene dhe përcakton të gjithë autoritetet dhe strukturat të cilat kanë përgjegjësi, detyrime dhe kompetenca në organizimin e këtij shërbimi, duke përfshirë dhe dispozitat kalimtare për nevojën e shfuqizimeve apo ndërhyrjen në akte të tjera ligjore për të bërë të mundur zbatimin e projektligjit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përmban në total **36 (tridhjetë e gjashtë) nene**, të organizuar në **2 (dy) krerë**, për të cilat parashtrjohet në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e tyre, si më poshtë.

Kreu I (nenet 1-15), përmbajnë rregulla të përgjithshme të këtij projektligji, që lidhen me objektin, qëllimin e projektligjit, si dhe parimet e përgjithshme për organizimin e këtij shërbimi, si: mosha e kryerjes së shërbimit, titullimi dhe gradimi, kohëzgjatja dhe kushtet e shërbimit, të drejtat dhe detyrimet, paga, vjetërsia në punë e shërbim.

Numri i personelit që do të aktivizohet në shërbimin ushtarak në rezervë përcaktohet në dokumentet strategjike të miratuara me ligj dhe do të jetë 25% të forcave aktive në përfundim të kompletimit të plotë që do të rezultojë në 2100 vetë, personel rezervist.

Shërbimi ushtarak në rezervë organizohet dhe funksionon si pjesë përbërëse e strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Për periudhën që shërbejnë si rezervistë me kontratë në strukturën që dëshiron, do të gëzojnë të gjitha të drejtat sipas ligjeve në fuqi për ushtarakët aktivë dhe në fund të periudhës së aktivizimit

duhet t'i bëhet një vlerësim, në përputhje me rregulloren e vlerësimit vjetor të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në nenet vijuese janë përcaktuar dhe rregullat e përgjithshme të pranimi në shërbimin ushtarak në rezervë.

Ushtarakut në rezervë, me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, i jepet grada ushtarake që ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura.

Shtetasi shqiptar që nuk ka shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe që plotëson kriteret e pranimi në shërbimin ushtarak në rezervë titullohet dhe i jepet grada e parë ushtarake, sipas përcaktimeve që parashikohen në aktet ligjore në fuqi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura.

Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak në rezervë është nga 14 deri në 45 ditë në vit. Për nevoja të stërvitjeve ushtarake, që zgjasin më shumë se 14 deri 45 ditë në vit, ministri i Mbrojtjes urdhëron bashkimin e ditëve të stërvitjes të dy viteve, por jo më shumë se 45 ditë.

Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak në rezervë mund të zgjatet mbi kohën e përcaktuar më sipër vetëm në rastet kur vendosen masat e jashtëzakonshme, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Si përjashtim ushtarakut në shërbimin rezervist mund t'i kërkohet të shërbejë më shumë se afati i përcaktuar në këtë projektligj në rastet kur: do të aktivizohet për të marrë pjesë në operacione në kuadrin e vendosjes së masave të jashtëzakonshme dhe për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje; do të aktivizohet për të marrë pjesë në operacione apo misione ushtarake ndërkombëtare të drejtuara nga OKB/NATO/BE-ja; aktivizohet për të marrë pjesë në operacione apo misione humanitare ndërkombëtare të drejtuara nga BE-ja, si dhe aktivizohet për të marrë pjesë në operacione në mbështetje të autoriteteve civile në emergjencat civile.

Shtetasi me pranimin në shërbimin ushtarak aktiv, nënshkruan kontratën e shërbimit ushtarak ku përcaktohet edhe koha e shërbimit ushtarak në rezervë për një periudhë jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.

Ushtarakët të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë dalë në rezervë sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë kriteret e pranimi të shërbimit ushtarak në rezervë, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrencës dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.

Për periudhën që shërbejnë si rezervistë me kontratë në strukturën që dëshirojnë, gëzojnë të gjitha të drejtat sipas ligjeve në fuqi njësoj si ushtarakët aktivë.

Ushtarakut të shërbimit në rezervë në fund të periudhës së aktivizimit duhet t'i bëhet një vlerësim, në përputhje me rregulloren e vlerësimit vjetor të ushtarakëve aktivë të Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Kreu II (nenet 16-36) përmban parashikime të hollësishme mbi përcaktimin dhe detyrimin e autoriteteve përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak në rezervë.

Në kuptim të këtij projektligji, autoritetet përgjegjëse sipas kompetencave do të jenë:

- a) Ministri i Mbrojtjes;
- b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
- c) Ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- ç) Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë;
- d) Ministri përgjegjës për punët e brendshme;
- dh) Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) Komandat e forcave dhe ato mbështetëse;
- ë) Qendra e Personel-Rekrutimit;
- f) Subjektet shtetërore dhe private.

Në nenet vijuese janë zbërthyer, kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrimet institucioneve, autoriteteve dhe strukturave të përmendura më sipër.

Gjithashtu, ky kre parashikon dhe rregullat për kontrollin e aftësive fizike nga komisionet mjekësore të kontrollit të aftësive për shërbimin ushtarak rezervist, marrjen në evidencë të ushtarakut dhe detyrimet për efekt të marrjes në evidencë pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në këtë projektligj.

Për kontrollin e aftësive të shtetasit për pranim në shërbimin ushtarak në rezervë, në strukturën mjekësore ushtarake të Forcave të Armatosura krijohet komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore.

Struktura përgjegjëse për rekrutimin do të dërgojë paraprakisht pranë strukturës mjekësore ushtarake të Forcave të Armatosura, listën e personelit ushtarak që do të kontrollohen për efekt të aktivizimit të tyre në shërbimin ushtarak rezervist.

Përbërja e komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë do të përcaktohen në rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut, e cila miratohet bashkërisht nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë.

Në vijim të argumentimit të mësipërm, evidentimi i ushtarakëve në rezervë, si burime njerëzore për kryerjen e detyrimit të shërbimit ushtarak në rezervë do të realizohet nga struktura përgjegjëse e Forcave të Armatosura për personel-rekrutimin.

Ushtarakët në rezervë merren në evidencë me daljen e tyre në rezervë nga shërbimi aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak, pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore

Neni 31 i këtij kreu përshkruan kundërvajtjet administrative, masën e dënimit me gjobë në rastet e shmangies së ushtarakut të shërbimit në rezervë të lidhura me detyrimet në fushën e evidencës ushtarake apo pjesëmarrja në stërvitje, trajnime dhe operacione të ndryshme ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Subjektet shtetërore dhe private që nuk përmbushin detyrimet sipas pikës 2, të nenit 13 dhe nenit 25 të këtij projektligji ndëshkohen me gjobë në masën e 20-fishit të pagës minimale mujore në shkallë vendi (referuar neni 202 të Kodit të Punës).

Nenet 33 e në vijim të këtij kreu përmbajnë parashikime që lidhen me nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, shfuqizimet e nevojshme të përcaktuara në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që bien ndesh me këtë ligj, rregullimin e regjimit kalimtar, si dhe hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, si dhe të gjitha institucionet apo organet ligjzbatuese, publike e private, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilave lidhen apo kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky projektligj do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Avokatit të Popullit, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe për dijeni Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka efekte financiare shtesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Kostoja fillestare e aktivizimit e përlogaritur për një numër efektivesh prej 2100 vetë, do të jetë në vlerën **1,527,183,144** lekë dhe kosto mesatare e mobilizimit për një afat kohor mesatar prej 40 ditë mobilizim në vit do të jetë në vlerën **826,072,512** lekë.

MINISTRI

Niko Peleshi